

PËRGATITJA E PLANIT TË KONSULTIMIT

1. Emri i ligjit/politikës të propozuar:

“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të Planit të Veprimit 2024–2026”

Audienca e synuar, lloji i konsultimeve (paraprake/k. për projekt-ligjet), metodat e konsultimit, kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit

Audienca e synuar	Lloji i konsultimeve: (1) konsultime paraprake, (2) konsultime për projekt-ligjit	Metodat e konsultimit (e-konsultimi, takimet publike, etj.)	Kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit dhe ftesave (e-mail, rrjetet sociale, etj.)
Publiku	(2)	Konsultim elektronik: publikimi në RENJK	e-mail koordinatori i Konsultimit Publik për MB Sara Shameti: Sara.Shameti@mb.gov.al
Grupet e interesit (p.sh. pushteti vendor, institucionet përgjegjëse për politikën e migracionit, shoqëria civile, akademikët, organizatat ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri, migratët, delegacioni i BE	(2)	Kontribute dhe komunikime të vazhdueshme përmes takimeve	2 takime të grupit ndërinstitucional të punës (GNP) dhe 5 aktivitete me grupin e punës (workshops, takime)

2. Afati kohor i aktiviteteve të konsultimit (nga fillimi deri në raportim)

Me Urdhërin e Kryeministrit nr. 9, datë 26.1.2023 u krijua Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të saj të Veprimit, i kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm dhe që në përbërje kishte anëtarë, përfaqësues të:

Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu është miratuar urdhri i Ministrit të Brendshëm nr.33 datë 13.3.2023 “Për ngritjen e grupit të punës në Ministrinë e Brendshme për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe planit të saj të veprimit”.

Takimi i parë i Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) u mbajt në datë 21 qershor 2023, në ambientet e Hotel Tirana Internacional. Në këtë takim morën pjesë edhe anëtarët e Grupit Drejtues për Migracionin (ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 35, datë 10.3.2021). Në takim u ftuan dhe morën pjesë edhe përfaqësues nga institucionet e tjera të përfshira dhe organizatat ndërkombëtare. Takimi pati në fokus të diskutimit problematikat e dala gjatë zbatimit të strategjisë dhe rekomandimet e Raportit përfundimtar të Progresit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2019-2022. Në takim u miratuan qëllimet politike dhe objektivat strategjike.

Me qëllim vijimin e punës në përputhje me prioritet e përcaktuara Ministria e Brendshme me mbështetjen e IOM kanë organizuar disa workshop-e kombëtare, në datat 9, 10 dhe 19 maj 2023. Workshop-et informuese të datave 9 dhe 10 maj kanë qenë të lidhura me zbatimin e Paktit Global për Migracionin (GCM) dhe identifikimin e objektivave prioritarë të tij që do të përfshihen në dokumentin strategjik.

Më 9 Maj 2023 u zhvillua një workshop-i me përfaqësuesit e institucioneve kryesore të Qeverisë së Shqipërisë dhe më 10 Maj 2023 një workshop me partnerët dhe grupet e interesit, ku morën pjesë përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri, shoqëria civile, sektori publik, academia etj.

Në datën 19 maj 2023, Ministria e Brendshme organizoi, me mbështetjen e IOM-it, një tjetër workshop “Për vlerësimin e situatës aktuale dhe prioriteteve kryesore në fushën e migracionit në Shqipëri, në funksion të hartimit të draftit të ri. Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit”. Në këtë takim punë morën pjesë përfaqësues të grupit ndërinstitucional për hartimin e Strategjisë, përfaqësues nga MB dhe institucionet kryesore përgjegjëse për migracionin, si dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë nga IOM. Gjatë takimit u prezantua një kornizë/strukturë fillestare e Strategjisë së ardhshme nga Sekretariati Teknik për Migrim në MB dhe ekspertë mbështetës të IOM-it.

Në datat 20-21 Shtator 2023, u zhvillua në Pogradec një workshop mbi hartimin e Strategjisë Kombëtare Për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2024-2030, ku ishin të ftuar, anëtarët e GNP-së, si dhe përfaqësues të të gjithë institucioneve të parashikuara si zbatuese kryesore dhe bashkëzbatuese të ndërhyrjeve konkrete. Workshopi u moderua dhe monitorua nga Sekretariati Teknik për Migracionin në MB, dhe ekspertët e IOM.

Drafti është konsultuar rregullisht me Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

Më datë 8 shtator 2023 është thirrur takim konsultativ me të gjithë aktorët ndërkombëtarë, DBE, IOM, UNHCR, FRONTEX, EUAA etj, për të prezantuar objektivat e Strategjisë dhe konsultimin apo kërkesat eventuale për mbështetje nga ana e partnerëve.

3. Burimet e nevojshme

Përshkruani nr. e stafit të nevojshëm, mjetet financiare dhe teknike të nevojshme etj.

- Burime njerëzore të nevojshme:

- Koordinator i punës për konsultimin në MB për mbledhjen e mendimeve nëpërmjet RENJK.
- Grupi ndërinstitucional i punës ngritur me urdhër të KM nr. 9, datë 26.1.2023 “Për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të saj të Veprimit, i kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm”.
- Grupi i punës miratuar urdhri i Ministrisë të Brendshme nr.33 datë 13.3.2023 “Për ngritjen e grupit të punës në Ministrinë e Brendshme për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe planit të saj të veprimit”.
- Drejtori dhe punonjësit e Drejtorisë së Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin.
- Ekspertët e fushës.

- Burime financiare të nevojshme:

Hartimi i këtij projektakti ka patur mbështetje nëpërmjet Organizatës së IOM “Mbështetje për hartimin dhe zbatimin e një Strategjie të re për Migracionin dhe Planit të Veprimit në Shqipëri”, për shpenzimet administrative të takimeve të grupit të punës dhe aktivitetet jashtë institucionit të Ministrisë së Brendshme.

Pajisje të nevojshme:

- Laptop, projektor, të siguruar nga institucioni i MB.

4. Mbledhja e përgjigjeve

Përshkruani mënyrën se si mendoni që të mblidhni përgjigjet.

Përgjigjet mblidhen përmes këtyre mënyrave:

- Regjistri RENJK <http://www.konsultimipublik.gov.al>.
- E-mail.

5. Monitorimi i procesit

Kjo matricë mund t'ju ndihmojë në monitorimin e vazhdueshëm pasi përfshin treguesit dhe metodat më të zakonshme për matjen e nivelit të suksesit të proceseve të konsultimit. Në fazën e planifikimit, ju duhet të përcaktoni vlerën e planifikuar të treguesve sasiore dhe metodave/mjeteve që do të përdorni për matjen e suksesit gjatë dhe në përfundim të procesit.

Treguesit dhe metodat për monitorimin e procesit

Korniza e procesit	Përshtatshmëria	Masat për përmirësime (deklaroni, si do të
--------------------	-----------------	---

		<i>përmirësoni procesin e pjesëmarrjes)</i>		
A u realizuan aktivitetet sipas afatit të planifikuar?	☐ po ☐ jo			
A u realizuan aktivitetet sipas burimeve financiare të planifikuara?	☐ po ☐ jo			
A u realizuan aktivitetet sipas burimeve njerëzore të planifikuara?	☐ po ☐ jo			
Treguesit sasiorë				
Treguesit sasiorë (deklaroni treguesit për monitorim)	Vlerat e planifikuara (deklaroni treguesit për vlerat)	Vlerat e arritura (deklaroni vlerën e arritur)	Përshtatshmëria	Masat për përmirësime (deklaroni si do të përmirësoni performancën)
<i>(plotësojeni gjatë fazës së planifikimit të procesit)</i>		<i>(plotësojeni gjatë monitorimit)</i>		
x ☐ numri i metodave të konsultimit	1 takim i grupit të punës dhe disa ndërveprime me email		☐ po ☐ jo	
x ☐ numri i palëve të përfshira			☐ po ☐ jo	
x ☐ numri i pjesëmarrësve			☐ po ☐ jo	
x ☐ numri i komenteve të pranuar			☐ po ☐ jo	
☐ tjetër:			☐ po ☐ jo	
Mjetet për matjen e treguesve				
x ☐ lista e pjesëmarrësve x ☐ raportimi i aktivitetit ☐ raporti i reagimeve				

☒ lista e komenteve të marra

☐ tjetër:

Treguesit cilësorë

Treguesit cilësorë (zgjidhni treguesit cilësorë - merrni parasysh objektivat e procesit të pjesëmarrjes)

Gjetjet
(deklaroni gjetet)

Masat për
përmirësime
(deklaroni si
do të
përmirësoni
performancën)

☐ cilësia e metodave të konsultimit

Ministria synon të vijojë përdorimin e metodave të ndryshme të konsultimit si RENJK, tryezë publike apo email sidomos me qytetarë, organizata të shoqërisë civile apo ekspertë të fushës

☐ përmbushja e pritshmërive të pjesëmarrësve

Përdorimi i sa më shumë metodave të konsultimit do të ndikojë jo vetëm në rritjen e numrit të pjesëmarrësve por dhe në forcimin e rolit që grupet e interesit, shoqëria civile apo shoqatat mund të kenë dhe rritjen e numrit të komenteve me qëllim përmirësimin e draftit.

☐ cilësia e komenteve dhe kontributeve të mara

Duke zhvilluar më shumë tryeza konsultimi apo duke përdorur sa më shumë metoda të konsultimit, do të rritet dhe pjesëmarrja e publikut e për pasojë dhe numri i komenteve të përcjella prej tyre.

☐ treguesit sipas objektivave të procesit:		
Mjetet për matjen e treguesve		
☐ pyetësi i vlerësimit x ☐ diskutimi joformal me pjesëmarrësit x ☐ regjistrimi i pikëpamjeve të pjesëmarrësve x ☐ raportimi i aktivitetit ☐ tjetër:		